



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:152710

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730553

Ac.nr.1694/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.H nga Gj....., Rr. “.....” nr....., të cilën me autorizim e përfaqëson E.H, avokat nga Gjilani, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Gjilan, për shkak të pagës jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2162/20, i datës 08.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2162/20, i datës 08.02.2022, në pikën II të dispozitivit për shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

II. Pika I e dispozitivit të aktvendimit të atakuar mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.2162/20, i datës 08.02.2022, ka vendosur: *“I. Padia e paditëses N.H nga Gj....., e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale në Gjilan me objekt kontesti, kompensimi i borxhit, KONSTATOHET SI E TËRHEQUR.*

II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale në Gjilan që të paditurës N.H t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 125.00€, edhe atë në afat prej 15 dite pas pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm”. Kundër këtij aktvendimi e paditura, përmes të autorizuarit të saj, në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke e atakuar pikën II të dispozitivit lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, me propozim që aktvendimi i atakuar ta prishet dhe lëndën të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, apo i njëjti të ndryshohet dhe të paditurit të mos i njihet e drejta e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësja

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me dt. 06.11.2020, ka ushtruar padi kundër të paditurës, lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar në emër të tri pagave në lartësi 1630.23 €, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovojë.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.2162/20 të dt. 08.02.2022, e ka konstatuar e tërhequr padinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitivin e të njëjtës.

Paditësja në këtë gjykatë me dt. 25.01.2022, ka paraqitur kërkesë për tërheqjen e pjesërishme të padisë, sa i përket kryegjësë së borxhit, ndërsa shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumë prej 125.00€, edhe atë shumën prej 104 për përpilimin e padisë dhe shumën prej 21€ për taksë gjyqësore. Gjykata të paditurës nuk i ka dërguar që e njëjta të jep pëlqim për tërheqje, për shkak se e paditura ka dorëzuar një parashtrësë të përgjithshme, ku ka njoftuar gjykatën se të gjithë punëtorët shëndetësor në kuadër të Komunës janë kompensuar nga ana e komunës, dhe këtë njoftim gjykata ka konsideruar si pëlqim që e paditura e jep për tërheqjen e padisë. Andaj nga të lartcekurat Andaj, Gjykata duke u bazuar në nenin 261.2 të LPK-së, ku shprehimisht është përcaktuar gjykata ka konstatuar tërheqjen e padisë, kurse në bazë të nenit të 454.1 të LPK-së e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 125 €.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nuk i ka pranuar pretendimet ankimore të palës paditëse dhe e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si në pikën dy (II) të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, me të cilin e ka detyruar paditësen që të paditurit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës, duke u bazuar

në nenin 456 paragrafi 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: "*Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t'ia shpërblej shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit.*", ndërsa neni 463 paragrafi 4 i LPK-së, ka përcaktuar se: "*Për kërkesën e palës për pagimin e shpenzimeve të procedurës, gjykata do të vendos në aktgjykimin ose aktvendimin me të cilin përfundon procedura përpara kësaj gjykate.*", andaj meqenëse pala e paditur i ka shkaktuar këto shpenzime procedurale dhe paditësja është tërhequr nga padia, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur ta obligojë të njëjtën për pagimin e këtyre shpenzimeve të cekura si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, prandaj aktvendimi në këtë pikë është vërtetuar, ndërsa pretendimet ankimore të palës së paditur u refuzuan të pathemelta.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditësit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të marr një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1694/2022, datë 16.05.2024

Kryetarja e kolegjit
Nora Bllaca Dula, d.v